



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE
TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 6044/11 Prot.

Tiranë, më 29.09.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1954, datë 26.07.2023.

SHOQËRISË “TETE ALBANIA TUNNEL & MINNING” SH.A

Rr. “Sami Frashëri”, Kompleksi Nobis, Kati 1, Tiranë

Për dijeni:

SHËRBIMI GJEOLLOJIK SHQIPTAR

Rruga “Zef Serembe”, Tiranë

Shoqëria “TETE ALBANIA TUNNEL & MINNING” SH.A, është zotëruese e Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1954, datë 26.07.2023, për mineralin bakër, në objektin “Perlat-Shebë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me shkresën Nr.1055, datë 01.09.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 6044 Prot., datë 02.09.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1954, datë 26.07.2023, për mineralin bakër, në objektin “Perlat-Shebë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, pasi shoqëria nuk ka realizuar volumet fizike dhe investimet e miratuara në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit mbi bazën e të cilit është miratuar leja e kërkim-zbulimit Nr.1954, datë 26.07.2023.

Propozimi është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ë” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet se “Zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit dështon në realizimin e programit minimal të punës.”

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Kërkim-Zbulimit** Nr.1954, datë 26.07.2023, për mineralin bakër, në objektin “Perlat-Shebë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1954, datë 26.07.2023, për mineralin bakër, në objektin “Perlat-Shebë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni

48 “Procedura e revokimit të lejes”, të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

AMI KOZELI

